

Master Shkencor në Drejtësi, *profili* “E Drejtë Tregtare”

Programi përfaqëson një korpus dijesh të thelluara në fushën e të drejtës tregtare, duke u përqëndruar veçanërisht në lëndë që jo vetëm janë të reja, por edhe në ndryshim dinamik në panoramën e legjislacionit shqiptar për t’iu përgjigjur ndryshimeve në botën e operatorëve të biznesit. Programi pasqyron një vëllim të konsiderueshëm dijesh në lidhje me format e ushtrimit të aktivitetit tregtar, subjektet e të drejtës tregtare, kontratat tregtare, të drejtën e ndërmjetësimit, arbitrazhit, të drejtën bankare, monetare dhe financiare, të drejtën tatimore dhe doganore, duke ofruar një pasqyrë krahasimore ndërmjet ligjit shqiptar dhe atij evropian.

Kurrikula

- o Mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut;
- o E drejtë e shoqërive tregtare
- o Metodot cilësore dhe sasore të kërkimit;
- o E drejta private evropiane;
- o E drejta financiare, bankare dhe monetare ndërkombëtare.

Karriera

Mundësi punësimi në:

- o Sektorin bankar ose financiar;
- o Sektorin e tatim – taksave;
- o Kompani tregtare vendase apo të huaja;
- o Studio avokatie vendase apo të huaja;
- o Zyra ndërmjetësimi apo arbitrimi, etj.



Kohëzgjatja & Forma e studimit

Studime me kohë të plotë

- Kohëzgjatja normale e studimeve në program
✓ **2 vite akademikë.**
- Kohëzgjatja maksimale e studimeve në program
✓ **4 vite akademikë.**

Kriteret

- o Kanë përfunduar dhe janë diplomuar në një program të ciklit të parë, i cili rezulton i licensuar në momentin e regjistrimit të studentit dhe i akredituar në momentin e diplomimit të studentit;
- o Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë, të licensuar dhe akredituar dhe diploma e tyre është njehtësuar nga MASR/QSHA.
- o Kanë përfunduar studime Bachelor në një fakultet me të njëjtin natyrë formimi (emërtimi) si dhe fakulteti i UniBa-së që mbulon programin e kërkuar.

Dokumentacioni mbështetës për aplikim:

1. Fotokopje Kartë Identiteti / pasaportë;
2. Fotokopje e diplomës së ciklit të parë e noterizuar / diplomë tjetër studimi e fituar jashtë shtetit dhe e njehsuar nga MASR;
3. Vërtetim i listës së notave dhe krediteve / suplementi i diplomës;
4. Fotokopje e noterizuar e diplomës së Maturës Shtetërore + Çertifikatë e notave, e konfirmuar nga DAR/ZA.
5. CV;
6. 2 fotografi;
7. Dëshmi e gjuhës së huaj, të paktën në nivelin B1;
8. Mandatë pagesa për tarifën e aplikimit të kryer në UniBa.



Kontakte të departamentit:

+355 68 20 85 434

✉ law.co@umb.edu.al | e.lloha@umb.edu.al